**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE**
**Nr.** 23327

29927

**V E N D I M**
**PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK**

Sot më datë 26.06 2003 (dymije e tre ) unë ____________ , gjyqetare prane Gjykates se shkalles pare Tiranë , pasi u njoha me kerkesen e bere nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z. Adrian Xhillari**

**K O N S T A T O V A:**

Kërkuesi kerkon regjistrimin si person juridik i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **" VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z Adrian Xhillari** kapital themeltar 100.000 (njëqindmije leke) , kohëzgjatje mbi 10 vjetë, me seli ne Tirane,Rr" Kavajes" Pallati I shoqerise SPEED,kati I pare, me administrator të shoqërisë **Z.Adrian Xhillari** , për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

"Tregti me shumicë e pakice. Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.
Tregetim me shumice e pakice. Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike, elektroteknike. mekanike, hidrosanitare e materiale ndertimi"

Duke qene se veprimtaria e shoqerise se mesiperme percaktuar ne statutin e saj nuk bie ne kundershtim me ligjin Nr. 7638 date 19.11 1992 "Per Shoqerite Tregtare " per tu regjstruar si person juridik

**PER KETO ARESYE :**

Bazuar në Ligjin nr.7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Nenit 5 të ligjit nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për Rregjistrimin në Rregjistrin Tregtar"

**V E N D O S A:**

Të regjistroje si person juridik shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **" VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z.Adrian Xhillari** , kapital themeltar 100.000 (njëqindmije leke) , kohëzgjatje mbi 10 vjetë, me seli ne Tirane Rr Kavajes Pallati I shoqerise SPEED, kati i pare me administrator të shoqërisë **Z. Adrian Xhillari ,** për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

"Tregti me shumicë e pakice. Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.
Tregetim me shumice e pakice. Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike, elektroteknike. mekanike, hidrosanitare e materiale ndertimi"

Kundër këtij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.
Tiranë,më 26 .06 2003

**GJYQTARE**

GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 23327

**V E N D I M**
**PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK**

Sot më datë 26.06 2003 (dymije e tre ) unë Ahuela Copa gjyqetare prane Gjykates se shkalles pare Tiranë , pasi u njoha me kerkesen e bere nga shoqëria me pergjegjesi te kufizuar **"VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z. Adrian Xhillari**

**K O N S T A T O V A:**

Kërkuesi kerkon regjistrimin si person juridik i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **" VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z Adrian Xhillari** kapital themeltar 100.000 (njëqindmije leke) , kohëzgjatje mbi 10 vjetë, me seli ne Tirane,Rr" Kavajes" Pallati I shoqerise SPEED,kati I pare, me administrator të shoqërisë **Z.Adrian Xhillari** , për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

**"Tregti me shumicë e pakice. Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.**
Tregetim me shumice e pakice, Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike, elektroteknike. mekanike, hidrosanitare e materiale ndertimi"

Duke qene se veprimtaria e shoqerise se mesipenne percaktuar ne statutin e saj nuk bie ne kundershtim me ligjin Nr. 7638 date 19.11 1992 "Per Shoqerite Tregtare " per tu regjistruar si person juridik

**PER KETO ARESYE :**

Bazuar në Ligjin nr.7638 datë 19.II.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Nenit 5 të ligjit nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për Rregjistrimin në Rregjistrin Tregtar"

**V E N D O S A :**

Të regjistroje si person juridik shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **" VIKI " SH.P.K.** me ortak të vetem **Z.Adrian Xhillari** , kapital themeltar 100.000 (njëqindmije leke) , kohëzgjatje mbi 10 vjetë, me seli ne Tirane Rr Kavajes Pallati I shoqerise SPEED, kati i pare me administrator të shoqërisë **Z. Adrian Xhillari** , për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

"Tregti me shumicë e pakice. Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.
Tregetim me shumice e pakice. Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike. elektroteknike. mekanike. hidrosanitare e materiale ndertimi"

Kundër këtij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.
Tiranë,më 26.06 2003

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 28827/1 Vendimi

**VENDIM**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane, sot me daten 27.2.2004, une gjyqtarja G. Byz) e shkalles se pare, Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi, Adrian Xhillari, administrator i shoqerise « VIKI » shpk

**KONSTATOVA**

Se me Vendimin Nr 29927 date 26.06. 2003 te Gjykates shkalles pare Tirane, eshte vendosur regjistrimi I Shoqerise "VIKI "shpk

Gjithashtu me vendimin Nr.1 date 05.02.2004 te Mbledhjes se Jashtezakonshme te ortakut te shoqerise "VIKI "shpk, ortaku Adrian Xhillari, ka vendosur te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerire ,duke bere shtese ne nenin 2 te Statutit:

"Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe te projektimit , punime dheu sistemime taracime terrenesh, ndertime civiledhe ekonomike , ndertime rrugesh kategoria V, IV , veshje me asfalto beton te rrugeve, ndertim mbi shtrese si dhe sistemim e asfaltim shtrese,ndertim ujsejllesi dhe kanalizime , rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike , veshje fasadash dhe mirembajtje zhvillim te dekorit ne mjediset urbane prodhime te materialeve te ndertimit prodhim dyer dhe dritare dural alumini , prodhime druri , metalike plastike, ndertim vepra arti te vogla deri 6 m , punime karpentierie , montim dhe insatlim te impianteve higjenike , kuzhina lavanderi , hidrosanitare dhe mirmbajtja e tyre , punime bojatisjeje , hidroizolimi termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve tekonoligjike , pastrim I siperfaqes urbane , projektim I veprave te zakonshme prej murature tuule , guri betoni , beton armeje e metalike » .

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura I plotesojne te gjitha kerkesat e kushtet ligjore, ajo duhet te pranohet.

**P. K. A.**

Ne baze te Ligjit nr. 7667"Per regjistrimin ne regjistrin tregtar " dhe ligjit 7638 date 19.11.1992"Per Shoqerite tregetare "

**VENDOSA**

Pranimin e kerkeses

Depozitimin ne rregjistrin tregtar te Vendimit Nr.1 Dt.05.02.2004 te Ortakut te vetem Shoqerise "VIKI "shpk Adrian Xhillari dhe pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Akt Themelimi dhe ne Statut.

Te urdherohet Zyra e Rregjistrit tregtar Tirane , te beje ndryshimet ne kollonat perkatese

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit .

Tirane me 27.2. 2004

**GJYQTARE**

[signature]

PULLE TAKSE 100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 29927/1 Vendimi

# VENDIM
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 23. 2 - 2004, une gjyqtarja e shkalles se pare, Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi, Adrian Xhillari, administrator i shoqerise « VIKI » shpk

## KONSTATOVA

Se me Vendimin Nr 29927 date 26.06. 2003 te Gjykates shkalles pare Tirane, eshte vendosur regjistrimi I Shoqerise "VIKI "shpk

Gjithashtu me vendimin Nr.1 date 05.02.2004 te Mbledhjes se Jashtezakonshme te ortakut te shoqerise "VIKI "shpk, ortaku Adrian Xhillari, ka vendosur te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerire ,duke bere shtese ne nenin 2 te Statutit:

"Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe te projektimit , punime dheu sistemime taracime terrenesh, ndertime civiledhe ekonomike , ndertime rrugesh kategoria V, IV , veshje me asfalto beton te rrugeve, ndertim mbi shtrese si dhe sistemim e asfaltim shtrese.ndertim ujesjellesi dhe kanalizime , rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike , veshje fasadash dhe mirembajtje Zhvillim te dekorit ne mjediset urbane prodhime te materialeve te ndertimit prodhim dyer dhe dritare dural alumini , prodhime druri , metalike plastike ndertim vepra arti te vogla deri 6 m , punime karpenterie , montim dhe insatlim te impianteve higjenike , kuzhina lavanderi , hidrosanitare dhe mirembajtje e tyre , punime bojatisjeje , hidroizolimi termoizolimi , akustike e kundra zjarrit te impianteve tekonologjike , pastrim i siperfaqes urbane , projektim i veprave te zakonshme prej murature tulle , guri betoni , beton armeje e metalike »

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura I plotesojne te gjitha kerkesat e kushtet ligjore, ajo duhet te pranohet.

## P. K. A.

Ne baze te Ligjit nr. 900? Per regjistrimin ne regjistrin tregtar " dhe ligjit 7638 date 19.11.1992"Per Shoqerite tregetare "

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses

Depozitimin ne regjistrin tregtar te Vendimit Nr.1 Dt.05.02.2004 te Ortakut te vetem Shoqerise "VIKI "shpk Adrian Xhillari dhe pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Akt Themelimi dhe ne Statut.

Te urdherohet Zyra e Rregjistrit tregtar Tirane , te beje ndryshimet ne kollonat perkatese

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit .

Tirane me 23. 2. 2004

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE***
***Nr. 29927/2 Vendimi***

## *VENDIM*

## *I GJYQTARIT TE VETEM*

Ne Tirane, sot me date 07.09/2005, une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ....A. Coco........, pasi shqyrtova kerkesen e z.Adrian Xhillari dhe Ervin LLozhi, Administratore te shoqerise "VIKI" sh.p.k ;

## *K O N S T A T O V A*

Se me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.29927 date 26/06/2003 eshte vendosur Regjistrimi si person juridik i shoqerise tregtare "VIKI"sh.p.k me Administrator dhe ortak te vetem Adrian Xhillari, me kapital themeltar 100 000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Rr. "Kavajes" pallati i shoqerise "SPEED" kati i pare, me veprimtari sipas objektit te percaktuar ne Statutin e shoqerise.Gjithashtu me Vendimin Nr.29927/1 date 23/02/204 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte miratuar shtimi i objektit te vpermtarise se shoqerise sipas permbajtjes se ketij Vendimi.

Me Vendimin Nr.2 date 01/09/2005 te Ortakut te vetem te shoqerise "VIKI"sh.p.k, eshte vendosur transferimi i 50% te kuotave te kesaj shoqerie nga ortaku i vetem Adrian Xhillari ne favor te Bleresit Ervin Llozhi nepermjet Kontrates se Shitjes se kuotave date 01.09.2005. Gjithashtu sipas ketij Vendimi eshte vendosur qe shoqeria do te administrohet bashkerisht nga Bleresi Ervin Llozhi dhe ortaku tjeter Adrian Xhillari te cilet do te jene bashkadministratore.

Kerkesa eshte e drejte, e mbeshtetur ne ligj dhe si e tille ajo duhet pranuar.

## *PER KETO ARSYE*

Ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar"

## V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit Nr.2 Date 01/09/2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "VIKI" Sh.p.k si dhe te Kontrates se shitblerjes se kuotave ku shoqeria "VIKI"sh.p.k behet me 2 ortake me nga 50% te kuotave secili dhe do te administrohet nga z.Adrian Xhillari dhe z.Ervin Llozhi si bashkadministratore.
- Te behen shenimet perkatese ne kolonat 4 dhe 5 dhe te ndahen regjistrimet me vije te kuqe nga njeri tjetri.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit.

**GJYQTARE**

Adriana Coco

*REPUBLIKA E SHQIPERISE*
*GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE*

*Nr. 29927/3 VENDIMIT*

# VENDIM
## *I GJYQTARIT TE VETEM*

Sot me date 12/01/2006 unë gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Ariana Caco, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "VIKI" sh.p.k, z. Adrian Xhillari, per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "VIKI " Sh.p.k.

## *K O N S T A T O V A:*

Se shoqeria "VIKI"sh.p.k eshte rregjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.Nr.29927 date 26/06/2003.Me Vendimin Nr.29927/2 date 07/09/2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur futja ne shoqerine "VIKI"sh.p.k edhe e shtetait Ervin Llozhi. Bazuar ne ligjin nr.7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregetare", Asambleja e jashtzakonshme e ortakeve te shoqerise, me vendimin nr. 3, date 29/12/2005, ka vendosur:
1.Të miratoje kerkesen e shtetasit shqiptar Ervin Llozhi per largimin nga shoqeria dhe shitjen e 50% (pesedhjete perqind) te kuotave qe ky ortak zoteronte ne shoqerine "VIKI" sh.p.k Tirane, dhe kalimin e tyre ne favor te ortakut tjeter Adrian Xhillari i cili behet zoterues i 100% te kuotave.
2.Të hartohet Kontrata perkatese e shitjes se Kuotave.
3.Hiqet asambleja e ortakeve te shoqerise si organ drejtues i shoqerise dhe vendoset ortaku i vetem organ drejtues i saj
4.Te behet depozitimi i Akteve ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe te behen shenimet ne skedat perkatese te regjistrit tregtar.
5.Te pasqyrohen keto ndryshime ne aktet e shoqerise.
6.Depozitimin e ketij vendimit ne Zyren e Rregjistrit tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane .
Shitblerja e kuotave eshte realizuar me kontraten e shitjes se kuotave nr.6850 rep; nr. 919 kol; date 29/12/2005, perpiluar nga notere Dhimitra Qarri.
Me kerkesen drejtuar Gjykates, kerkuesi ka kerkuar:

1.Depozitimin e kontrates se shitjes se kuotave date 29/12/2005 dhe vendimit nr. date 29/12/2005, ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane
2.Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise.
Persa me siper nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

***PER KETO ARESYE:***

Ne baze te ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe ligjit 7638 date 1911.1992 "Per Shoqerite Tregetare „;

***V E N D O S A :***

1. Pranimin e kerkeses,
2. Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane te kontrates se shitjes se kuotave nr. 6850 rep, nr.919 kol, date 29/12/2005, Vendimit nr.3, date 29/12/2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "VIKI"sh.p.k Tirane, per largimin nga shoqeria te ortakut Ervin Llozhi.
3. Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rethit Gjyqesor Tirane te beje ndryshimet ne kolonen ............ germa ..........ne regjistrin tregtar.
4. Te ndahen regjistrimet me vije te kuqe nga njeri tjetri.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

***GJYQTARE***

***Ariana CAÇO***

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
Nr. 29927/4 vendimit

# VENDIM

I gjyqtarit te vetem

Ne Tiranes sot ne daten 16.02. 2006 une M. Luma gjyqtare ne gjykaten e rrethit gjyqsor, pasi u njoha me kerkesen e administratorit Xhorxho Daka, per depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise "VIKI" shpk,

## KONSTATOVA:

Se shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "VIKI" shpk eshte regjistruar person juridik me vendimin nr.29927 date 26.06.2003 te gjykates shkalles pare Tirane me ortak te vetem dhe administrator Adrian Xhillari, me kapital themeltar 100.000 leke. Ne daten 07.02.2006, kerkuesi Xhorxho Daka ka blere kapitalin themeltar te shoqerise "VIKI" shpk, eshte bere ortak i vetem dhe administrator i saj. Adrian Xhillari eshte larguar si ortak nga shoqeria "VIKI" shpk.

Me nenshkrimin e kontrates shitjes dhe blerjen e gjithe kapitalit te shoqerise "VIKI", ortaku Xhorxho Daka, ka marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise.

Administratoi kerkon te depozitohen ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane, vendimi date 07.02.2006 i ortakut te vetem dhe kontrata e shitjes kapitalit.

## PER KETO ARESYE:

Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjin 767 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar",

## VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "VIKI" shpk qe jane:

- Vendimi i ortakut te vetem date 07.02.2006,
- Kontrata e shitjes kapitalit.

Urdherimin e zyres regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane te beje ndryshimet ne kolonen ............ e regjistrit tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Mimoza Luma

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
Nr.22827/1 vendimit

# VENDIM

I gjyqtarit te vetem

Ne Tiranes sot ne daten 06/12/ 2006, une M. Deçi gjyqtare ne gjykaten e rrethit gjyqsor, pasi u njoha me kerkesen e administratorit Xhorxho Daka, per depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise "VIKI" shpk,

**KONSTATOVA:**

Se shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "VIKI" shpk eshte regjistruar person juridik me vendimin nr.29927 date 26.06.2003 te gjykates shkalles pare Tirane, aktualisht me ortak te vetem dhe administrator Xhorxho Daka, me kapital themeltar 100.000 leke. Ne daten 15.07.2006 ortaku i vetem Xhorxho Daka ka ndryshuar seline e shoqerise dhe e ka bere ate ne adresen rruga e "Kavajes", pall."Albisna", ap.2/4, Tirane.

Administratoi kerkon te depozitohet ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane, vendimi date 15.07.2006 i ortakut te vetem.

**PER KETO ARESYE:**

Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjin 767 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar",

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane te dokumentit te paraqitur ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "VIKI" shpk qe eshte:

-Vendimi i ortakut te vetem date 15.07.2006 per ndryshimin e selise se shoqerise duke e vendosur ne adresen rruga e "Kavajes", pall."Albisna", ap.2/4, Tirane.

-Urdherimin e zyres regjistrit tregtar te gjykates rrethit gjyqsor Tirane te beje ndryshimet ne kolonen ....4..... e regjistrit tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Marsida Deçi

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**NR.**29927/6 **vendimi**

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 7.2. 2007, une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e ortakut Xhorxho DAKA per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit date 24.01.2007 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare " VIKI" sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

## K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.29927, dt.26.06.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " VIKI " sh.p.k aktualisht me ortak te vetem Xhorxho DAKA.|

Aktualisht Ortaku i Vetem me vendimin date 24.01.2007 ka vendosur

1. Caktimin e ekespertit Nikolla Geco per vleresimin e kapitalit.
2. Depozitimin e ketyre ndiyshimeve ne rregjistrin tregtar. Ne keto kushte kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregetar"

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit dt. 24.01.2007 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare " VIKI "sh.p.k.

Shenimin ne fleten perkatese ne kolonen____.

Regjistrimet te behen me nr. rendor _______ , duke u ndare nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Blerina Lugaj

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**NR. 29927/7 vendimi**

## V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 30.05.2007, une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e Ortakut te Vetem z. Xhorxho DAKA te shoqerise " VIKI" sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

## K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.29927, dt. 26.06.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria " VIKI " sh.p.k me ortak Xhorxho DAKA.

Me vendimin nr. 29927/6 date 07.02.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur:

- Caktimin e ekspertit Nikolla Geco i cili do te pergatise raportin kontabel duke mundesuar ne kete menyre rrtjen e kapitalit themeltar te kesaj shoqerie.

Ortaku i Vetem i shoqerise "VIKI" sh.p.k. me vendimin date 08.02.2007 ka vendosur:

1. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel te miratuar Nikolla Geco.
2. Rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise me shumen 39.900.000 leke ( tridhjete e nentemilion e nenteqind mije) e cila eshte e perbere me 39.900 pjese te reja me vlere 39.900.000 leke.
3. Kapitali themeltar i shoqerise me kete rritje shkon ne masen 40.000.000 leke (dyzetmilion).

Gjykata konstaton se kapitali themeltar i kesaj shoqerie rezulton i zmadhuar.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore

## PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregetar":

## V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Miratimin e raportit te ekespertit kontabel te miratuar Nikolla Geco.

4. Rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise ne masen 39.900.000 leke (tridhjete e nentemilion e nenteqind mije) e cila eshte e perbere me 39.900 pjese te reja me vlere 39.900.000 leke.
5. Pra si perfundim kapitali themeltar i shoqerise "VIKI" sh.p.k. shkon ne masen 40.000.000 leke (dyzetmilion).
6. Urdherimin e zyres se Regjistrit Tregetar per te depozituar Vendimin e Ortakut te Vetem te shoqerise "VIKI" sh.p.k..

- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARE

ELBANA LLURI

Anullim regjistrimi

23927

- Emërtimi "Vila" Sh.p.k.
- Kapitali 100.000 lekë
- Kohëzgjatja mbi 10 vjet
- Me objekt: Tregti me shumicë e pakicë, import eksport etj.
- Me ortak dhe administrator të vetëm Adrian Milloni.
- Me seli Tiranë, rr. "Kavajës" ?

Statuti 5 fleta.
Akt themelimi 1 fletë
Data e vendimit 20.06.2007
Data e regjistrimit 26.06.2007

[signature]

**AKT - THEMELIMI**

# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " VIKI " SH.P.K.

Personi që firmos më poshtë :

**ADRIAN XHILLARI** biri I Simonit i datlindjes 1966, me banim ne Tirane Rr" Myslym Shyri P 7,shk 5,ap 38, me pashaporten Nr 0146958 ka hartuar si më poshtë vijon Aktin e Themelimit të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar të cilën ka vendosur ta themelojë :

Në mbështetje të ligjit nr. 7638 , datë 19. 11.1992 "Për shoqëritë tregtare", unë ortaku i vetëm **Adrian Xhillari** vendosa krijimin e Shoqërisë me Pergjegjësi të Kufizuar " **VIKI** " **SH.P.K.** për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

"Tregti me shumicë e pakice.Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.
Tregetim me shumice e pakice, Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike, elektroteknike, mekanike, hidrosanitare e materiale ndertimi"

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mije) lekë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe mbi 10 (dhjëtë) vjetë

Selia do të jetë ne Tirane Rr"Kavajes" Pallati I Shoqerise"SPEED" kati I pare.

Administratori i shoqërisë do të jetë z.Adrian Xhillari

Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga administratori i shoqërisë

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në Gjykaten e Rrethit .

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 2003 . Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 janar dhë përfundon më 31 dhjetor.

Çdo gjë që do të kryhet parashikohet në statutin që do të depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë .

Ky Akt - Themelimi është hartuar , më____.06.2003 në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore.

**Ortaku i vetëm i Shoqerise" VIKI" SH.P.K.**

**Adrian Xhillari**

Adrian Xhillari

**S T A T U T**
**I**
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**" VIKI"SH.P.K**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar"**VIKI** " sh.p.k. (e cila ketu me poshte quhet ''Shoqeria'' )eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit ,nga ortaku :
**ADRIAN XHILLARI** i biri i Simonit i datlindjes 1966, banuese ne Tirane Rr"Myslym Shyri"P 7,shk 5,ap 38,me pashaporten Nr 0146958.

Kjo **SHOQERI** ne perputhje me legjislacionin shqiptar e vecanerisht me Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 ''Per shoqerine tregtare '' krijohet nga **ORTAKU** I vetem i kesaj **SHOQERIE** per te ushtruar veprimtari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit apo nga ky STATUT .

**NENI 1**
**EMERTIMI**

**SHOQERIA** emertohet " VIKI" **sh.p.k.**
**SHOQERIA** eshte person juridik I se drejtes shqiptare dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te ketij **STATUTI .**
**SHOQERIA** do te quhet person juridik dhe do te veproje si e tille duke filluar nga dita e rregjistrimit te saj ne gjykate , ndersa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin e saj ne organet tatimore .

**NENI 2**
**OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti I veprimtarise se **SHOQERISE** eshte
"Tregti me shumicë e pakice.Import Eksport te paisjeve okulistike e laboratorike dhe kryerjen e vizitave mjeksore okulistike.
Tregetim me shumice e pakice, Import eksport te materialeve industriale, veshmbathje, pajisje elektrike, elektroteknike. mekanike, hidrosanitare e materiale ndertimi.

.

**NENI 3**
**QENDRA E SHOQERISE**

Selia e **SHOQERISE** ndodhet ne Tirane Rr"Kavajes" Pallati I shoqerise"SPEED" kati I pare.
**SHOQERIA** me vendim te organeve te saj kopetente , rast pas rasti , do te krijoj transferoje dhe ose anulloje seli dytesore , seli administrative , drejtori , filiale , dege , agjensi dhe zyra si ne teritorin shqiptar ashtu edhe jashte vendit .

## NENI 4
## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar mbi 10 vjet .

Me vendim te **ORTAKUT te vetem** kohezgjatja e **SHOQERISE** mund te caktohet tej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm .

## NENI 5
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar I **SHOQERISE** eshte 100.000 leke (njeqintemije).
E gjithe pjesa e kapitalit themeltar eshte nenshkruar ne teresine e saj nga Ortaku themelues .
Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre .

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themelor te SHOQERISE behet me vendim te **ORTAKUT TE VETEM** .

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te **SHOQERISE** ne te gjitha Bankat qe ndodhen ne teritorin e Shqiperise .
Transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial .

## NENI 6
## VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare te **SHOQERISE** pasqyrohen ne llogarite(kontabilitetin )e saj , duke aplikuar kriteret e dispozitat mbi kontabilitetin e shoqerive tregtare te parashikuara nga legjislacioni shqiptar .

## NENI 7
## BLERJET E SHOQERISE

**SHOQERIA** disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj .
**SHOQERIA** ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve .

## NENI 8
## BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

**SHOQERIA** per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e saj . Perberja , madhesia e tyre , burimet e krijimit , perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante vendoset nga **ORTAKU i VETEM i** saj ,duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi .

**SHOQERIA** disponon mjetet e saj financiare . Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se **SHOQERISE** do te mbulohen nga fondet perkatese apo fondet rezerve ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar .
Te gjitha pasurite e **SHOQERISE** pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare .

Bilanci dhe llogarite e **SHOQERISE** perpilohen e mbahen nga Administratori .

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

## NENI 9
## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

**SHOQERIA** administrohet nga **ADMINISTRATORI i** saj , z .Adrian Xhillari. i cili eshte njekohesisht edhe Ortaku i vetem i kesaj shoqerie ,i cili perfaqeson **SHOQERINE** ne mardhenie me te tretet .
**ORTAKU I SHOQERISE** mund ti delegoje kopetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure .
Vendimet e **ORTAKUT** te vetem evidentohen ne nje regjister te vecante .

## NENI 10
## ORTAKU I SHOQERISE

**ORTAKU I SHOQERISE** ushtron te gjitha kopetencat , te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e **SHOQERISE** te parashikuara nga ky statut , Akti I Themelimit si dhe nga legjislacioni tregtar shqiptar .
Ai ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet qe I konsideron te domosdoshme per realizimin e qellimeve te **SHOQERISE** , pa cenuar interesat e tij.

## NENI 11

**ORTAKU i vetem** i cili eshte njekohesisht edhe administratori i **SHOQERISE** pergjigjet per te gjithe veprimtarine e **SHOQERISE** qe nga momenti I themelimit te saj .

## NENI 12
## MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ndermjet **SHOQERISE** , filialeve e agjensive te saj (nese krijohen te tilla )dhe punonjesve te saj rregullohen me kontraten e punes . Per ceshtje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar .

## NENI 13
## NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne **STATUT** mund te behen me vendim te **ORTAKUT te vetem** dhe sipas dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin `` Per Shoqerite Tregtare ``.

**NENI 14**
**SHNDERRIMI I SHOQERISE**

**SHOQERIA** mund te shnderrohet ne nje shoqeri kolektive , komandite apo anonime me vendim te **ORTAKUT** te saj .
Shnderrimi I **SHOQERISE** ne nje shoqeri tjeter do te konsiderohet I vlefshem vetem duke respektuar dispozitat ligjore te parashikuara nga ligji " Per Shoqerite Tregtare ".

**NENI 15**
**PRISHJA E SHOQERISE**

**SHOQERIA** prishet ne rastet kur

a. mbaron afati I parashikuar ne Aktin e Themelimit .
**b.** nuk mund te realizohet objekti I **SHOQERISE** sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit .nje vendim te tille e merr **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE .**

**NENI 16**
**LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Likujdimi I **SHOQERISE** do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne castin e likujdimit .
**ORTAKU** I vetem vendos rregullat per proceduren e likujdimit si dhe per personat qe do ti aplikojne ato .

**NENI 17**
**DISPOZITE E FUNDIT**

Ky **STATUT** hyn ne fuqi diten e rregjistrimit te **SHOQERISE** ne Gjykaten e Rrethit Tirane .
Ky **STATUT** u njoh dhe u nenshkrua nga **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE** ne Tirane me .06..2003.

**ORTAKU I SHOQERISE " VIKI"sh.p.k.**
**Adrian Xhillari**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR/058REP.
NR.230 KOL.

**V E R T E T I M**

Sot ne daten .06.2003 (dymije e tre ) para meje noteres Adelina Nini u paraqit personalisht para meje Z Adrian Xhillari ,me gjeneralitetet e mesiperme, i cili deklaroi se sa me siper eshte nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote para meje noteres.

**N O T E R E**

**SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"VIKI "sh.p.k**

## V E N D I M Nr. 1
## I MBLEDHJES SE ORTAKUT TE SHOQERISE "VIKI"shpk

Sot me date 05.02.2004 une ortaku I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"VIKI "shpk Adrian Xhillari** ne mbledhjen e jashtezakonshme te ortakut

**V E N D O S A :**

1. Te bej shtese ne nenin 1 te Statutit te shoqerise me kete permbajtje"Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe te projektimit , punime dheu sistemime taracime terrenesh, ndertime civiledhe ekonomike , ndertime rrugesh kategoria V, IV , veshje me asfalto beton te rrugeve, ndertim mbi shtrese si dhe sistemim e asfaltim shtrese , nderti ujsjllesi dhe kanalizime , rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike , veshje fasadash dhe mirembajtje zhvillim te dekorit ne mjediset urbane prodhime te materialeve te ndertimit prodhim dyer dhe dritare dural alumini , prodhime druri , metalike plastike, ndertim vepra arti te vogla deri 6 m , punime karpentierie , montim dhe insatlim te impianteve higjenike , kuzhina lavanderi , hidrosanitare dhe mirmbajtja e tyre , punime bojatisjeje , hidroizolimi termoizolimi , akustike e kundra zjarit te impianteve tekonoligjike , pastrim I siperfaqes urbane , projektim I veprave te zakonshme prej murature tuule , guri betoni , beton armeje e metalike

Te depozitohet nje kopje e ketij Vendimi ne regjistrin tregetar te Gjykates shkalles pare Tirane

ORTAKU I SHOQERISE "VIKI"shpk

Adrian Xhillari

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**ZYRA E NOTERISE**
**T I R A N E**
**Nr. 182 Rep**

## *V E R T E T I M*

Sot me date 09.02.2004 ( dy mije e kater) , ne Zyren e Noterise Tirane u paraqit personalisht Adrian Xhillari I biri I Simonit I datlindjes 1966,me banim ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, me pashaporten Nr 0146958, I cili deklaroi se Vendimi I mesiperm eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe une noterja duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoj

Notere
Adelina Nini

*Shoqeria "VIKI"sh.p.k Tirane me Nr.29927 Vendimi date 26/06/2003*

# *V E N D I M*

## *Nr.2 Date 01/09/2005*

## *I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "VIKI" Sh.p.k*

Shoqeria "VIKI"sh.p.k eshte regjistruar me Vendimin Nr.29927 date 26/06/2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me ortak te vetem dhe Administrator Adrian Xhillari.Sot në datën 23/08/2005, në seline e shoqërisë në Rr."Kavajes" Pallati i shoqerise SPEED, kati i Pare Tiranë, ortaku i vetem Adrian Xhillari zotërues i 100% të kuotave të kapitalit te shoqerise, shqyrtoi kerkesen e shtetasit shqiptar Ervin Llozhi per blerjen e 50% te kuotave te shoqerise "VIKI"sh.p.k dhe kalimin e kesaj shoqerise ne shoqeri me 2 ortake. Bazuar ne Statutin e shoqerise dhe ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" Ortaku i vetem;

## *V E N D O S I:*

1. Të miratoje kerkesen e shtetasit shqiptar Ervin Llozhi per te blere 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te shoqerise "VIKI" sh.p.k Tirane.

2. Të hartohet Kontrata perkatese e shitjes se Kuotave mes Ortakut te vetem dhe Administratorit te shoqerise "VIKI"sh.p.k Adrian Xhillari dhe Bleresit Ervin Llozhi per kalimin dhe transferimin e 50% te Kuotave nga ortaku i vetem Adrian Xhillari tek Bleresi Ervin Llozhi.

3. Miratimin e kerkeses se Bleresit Ervin Lozhi per tu bere bashkeadministrator ne shoqerine "VIKI"sh.p.k me ortakun e vetem dhe Administratorin aktual Adrian Xhillari.

4. Te behet depozitimi i Akteve ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane dhe te behen shenimet ne skedat perkatese te regjistrit tregtar.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "VIKI"sh.p.k

*Adrian XHillari*

Adrian Xhillari

*REPUBLIKA E SHQIPERISE*
*DHOMA E NOTERISE TIRANE*
*Nr.2137 Rep.*
*Nr.185 kol*

# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot ne daten 01/09/2005 (dymije e pese), ne zyren e Noterise Tirane perpara meje notere/RENA CANA u paraqiten personalisht shtetasit :

*1-z.Adrian Xhillari,* i biri i Simonit i lindur me 14.03.1966 ne Tirane e banues ne Tirane madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me pasaporte Nr.Z 1113470 ortak i vetem dhe administrator i shoqerise *"VIKI"sh.p.k,* me seli ne Tirane e regjistruar me Vendimin Nr.29927 date 26/06/2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me poshte referuar *SHITESI.*

2-z.Ervin LLOZHI i biri i Fiqiriut dhe Diturise , lindur me 20.01.1982 ne Burrel e banues ne Tirane ne adresen Rr. "M.Keta" p.4, sh.6, ap.57, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me pasaporte Nr.Z0314762me poshte referuar *BLERESI.*

*OBJEKTI I KONTRATES* : Eshte kalimi i drejtes se pronesise se 50% te kuotave te kapitalit qe zoteron ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise *"VIKI"sh.p.k* Adrian Xhillari sipas Vendimit Nr.29927 date 26/06/2003te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nepermjet Kontrates se Shitjes duke i trasferuar perkatesisht 50% (pesedhjete perqind) te kuotave ne favor te Bleresit Ervin Llozhi.

*BAZA LIGJORE*: Kjo Kontrate hartohet bazuar ne Nenin 705 e vijues te K.Civil, dhe Nenet 47 dhe 49 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare".

*ÇMIMI I SHITJES:1*-Bleresi Ervin Llozhi do te bleje 50% te kuotave te shoqerise "VIKI"sh.p.k ne shumen 50 000 leke, pagese e cila behet nga Bleresi ne favor te shitesit jashte kesaj zyre noteriale........

Shoqeria *"VIKI"sh.p.k* eshte regjistruar me Vendimin Nr.29927 date 26/06/2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me kapital themeltar 100 000 leke i ndare ne 100 kuota me nga 1000 leke secila, kapital i zoteruar teresisht nga ortaku i vetem dhe Administratori i saj shtetsi Adrian Xhillari. Shoqeria ka seline ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes" pallati i shoqerise "SPEED"sh.p.k kati i pare, me kohezgjatje mbi 10 vjet te ushtrimit te veprimtarise dhe objekt veprimtarie te percaktuar sipas Statutit dhe Vendimeve perkatese te Gjykates.

Me Vendimin nr 29927/1 date 23/02/2004 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise ka shtuar objektin e veprimtarise se duke e zgjeruar veprimtarine e shoqerise edhe ne fushen e ndertimit.

Me anen e kesaj kontrate Shitblerje te kuotave, ortaku i vetem dhe Administrator i shoqerise z.Adrian Xhillari kalon ne favor te bleresit Ervin Llozhi 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, nga 100% te kuotave qe zoteron shitesi Adrian Xhillari. Pas kesaj shitjeje ortaku i vetem dhe Administratori i shoqerise Adrian Xhillari humbet pronesine e 50% te kuotave te shoqerise "VIKI"sh.p.k, kjo e barabarte me 50 000 leke dhe do te zoteroje 50% (pesedhjete perqind) te kuotave te kapitalit. Me kete Kontrate shitje ortaku i ri Bleresi Ervin Llozhi behet pronar i 50% te kuotave ne kete shoqeri dhe zoterues i 50% te kuotave te shoqerise "VIKI"sh.p.k Tirane. Administratore te shoqerise do te jene bashkpronaret ortake te shoqerise Adrian Xhillari dhe Ervin Llozhi te cilet me vone do te bejne edhe ndryshimet perkatese ne Statut.Bashklidhur kesaj Kontrate eshte edhe Vendimi i Ortakut te Vetem te shoqerise per miratimine shitjes se 50% te kuotave Bleresit Ervin Llozhi.

Bashklidhur kesaj Kontrate Vendimet Nr.29927 date 26/06/2003 dhe Nr.29927/1 date 23/02/2004 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Palet kontraktuese pasi e lexuan dhe kuptuan permbajtjen e kesaj kontrate, u binden se permbajtja e saj shpreh vullnetin e tyre te plote e te lire, e nenshkruan ate personalisht pa verejtje perpara meje noterit dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tyre rregullisht sipas ligjit.

| | |
|---|---|
| *SHITESI* | *BLERESI* |
| *Adrian XHILLARI* | *Ervin LLOZHI* |

**Nr.3 Date 29/12/2005**

**I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE "VIKI" Sh.p.k**

Shoqeria "VIKI"sh.p.k eshte regjistruar me Vendimin Nr.29927 date 26/06/2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me ortak te vetem dhe Administrator Adrian Xhillari.Me Vendimin Nr.19927/2 date 07/09/2005 ortake me nga 50% te kuotave dhe bashkadministratore te kesaj shoqeria jane Adrian Xhillari dhe Ervin LLOZHI.Sot në datën 29/12/2005, në seline e shoqërisë në Rr."Kavajes" Pallati i shoqerise Speed, kati i 9-te Tiranë, ortaket e shoqerise Adrian Xhillari zotërues i 50% të kuotave të kapitalit te shoqerise, si dhe Ervin Llozhi zoterues i 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise "VIKI"sh.p.k, pasi shqyrtuan kerkesen e ortakut Ervin Llozhi per shitjen e 50% te kuotave te shoqerise "VIKI"sh.p.k ne favor te ortakut tjeter Adrian Xhillari, bazuar ne Statutin e shoqerise dhe ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" Asambleja e jashtzakonshme e shoqerise me votim unanim te ortakeve;

***VENDOSI:***

1. Të miratoje kerkesen e shtetasit shqiptar Ervin Llozhi per largimin nga shoqeria dhe shitjen e 50% (pesedhjete perqind) te kuotave qe zoteron ne shoqerine "VIKI" sh.p.k Tirane, dhe kalimine tyre ne favor te ortakut tjeter Adrian Xhillari.
2. Të hartohet Kontrata perkatese e shitjes se Kuotave.
3. Hiqet asambleja e ortakeve te shoqerise si organ drejtues i shoqerise dhe vendoset ortaku i vetem organ drejtues i saj
4. Te behet depozitimi i Akteve ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe te behen shenimet ne skedat perkatese te regjistrit tregtar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE "VIKI"sh.p.k

| Adrian XHILLARI | Ervin LLOZHI |
|---|---|
| Adrian Xhillari | Ervin Llozhi |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 6849 Rep.
Nr. 918 kol

# VERTETIM

Sot me date 29/12/2005 dymije e pese, ne Tirane para meje noteres Dhimitra Qarri me seli ne Tirane u paraqiten:

Adrian Xhillari i biri i Simoni, datelindja 14.03.1966 dhe banues ne Tirane, **identifikuar me pasporte** Nr. Z 1113470 dhe Ervin Llozhi, i biri i Fiqiriut, datelindja 20.01.1982, banues ne Tirane, rruga"M. Keta", pall.4.sh.6. ap.57, identifikuar me pasaporte nr.Z0314762, ortake te shoqerise "VIKI"sh.p.k. madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se sa me siper eshte Vendimi i Asamblese se jashtzakonshme te shoqerise "VIKI"sh.p.k eshte hartuar me vullnet te plote e te lire prej tyre, e nenshkruan ate personalisht perpara meje dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit

NOTER

Page Break

NOTERE
DHIMITRA
QARRI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANe**
**Nr.6850 Rep.**
**Nr.P/P kol**

## KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot ne daten 29/12/2005 (dymije e pese), ne zyren e Noterise Tirane perpara meje notere Dhimitra QARRI me seli Rr. "B.Curri"perballe Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane u paraqiten personalisht shtetasit :

